



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 22.13.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË
RAHOVECIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit, Mehmet Muçaj, Fikret Ibrahimianëtar, dhe Muharrem Qyqalla-anëtar nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	23
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	24
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	27
Shtojca IV: Letër konfirmimi	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor i Komunës së Rahovecit për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 01.12.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Më gjerësisht, shih Shtojcën 1.

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i Çështjes

Si Theksim i Çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se regjistri kontabël i pasurive nuk është i plotë sepse tokat në vlerë prej 541,787€ dhe 6 pagesa në vlerë 120,036€, të ekzekutuara në vitin 2016 për investime kapitale, nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të pasurive. Po ashtu, komuna kishte bërë keq klaisifikim të shpenzimeve dhe nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar 74,299€ për mallra dhe shërbime.

Për më gjerësisht, shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Për shkak të rëndësisë së informatës lidhur me nënvlerësimin e pasurive dhe keq klasifikimin e shpenzimeve, ne e kemi theksuar opinionin e auditimit.



Kryetari duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin e Çështjes në 2016 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të klasifikimit të shpenzimeve dhe pasurisë në 2017 (shih nënkapitulli 1.1).

Komuna nuk i kishte zbatuar në shkallën e duhur rekomandimet e auditimit të dhëna vitin e kaluar, dhe për pasojë, shumë nga dobësitë nuk janë përmirësuar.



Kryetari duhet të sigurojë se plani i veprimit zbatohet me kohë dhe në mënyrë efektive për të gjitha rekomandimet e dhëna, me fokus të veçantë tek ato me prioritet të lartë (shih çështja 1).

Rishikimi i pyetësorit të vetëvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal, ka konfirmuar se komuna ende nuk ka plan strategjik gjithëpërfshirës, listën e rreziqeve të cilat mund të kanosin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.



Kryetari duhet të sigurojë se do të bëhet një vlerësim kritik gjatë hartimit të pyetësorit të vetëvlerësimit, do të mbështetet me dëshmi, të hartoj planin strategjik gjithëpërfshirës dhe regjistrin e rreziqeve (shih çështja 2 dhe 3).

Në fushën e prokurimit vazhdojnë të ekzistojnë dobësi të identifikuara edhe më heret, të cilat mund të rezultojnë me vlerë të dobët për para.



Kryetari duhet të analizojë dobësitë e identifikuara në prokurim dhe të ndërmerë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjen 7 dhe 8).

Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin e vitit të 2016

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet e dhëna.

Ne konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtojë Raportin e Auditimit në asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutojë në asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e planit të veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV e vitit 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV të Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të PFV.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se regjistri kontabël i pasurive nuk është i plotë sepse tokat në vlerë prej 541,787€, dhe 6 pagesa në vlerë 120,036€, të ekzekutuara në vitin 2016 për investime kapitale nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të pasurive.

Po ashtu, komuna nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale kishte paguar 74,299€, të cilat për nga natyra janë mallra dhe shërbime. Prej tyre, më kryesoret janë: rrënimi i objekteve pa leje (10,000€), largimi dhe pastrimi i mbeturinave të ngurta (10,000€), dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i hapësirave publike (17,475€). Kjo shumë ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2016 si investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale. Gabimet kanë të bëjnë me gabime në planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga komuna, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e komunës, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të komunës.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntëmujore Financiare me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2016; dhe
- Nëse PVF janë përgatitur dhe nënshkruar me kohë.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi .

Në draft PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare dhe kemi dhënë edhe disa sugjerime të për të përmirësuar cilësinë e tyre, si në vijim:

- Në nenin 14 te hyrja e parasë së gatshme – Komuna kishte prezantuar gabimisht vlerën 247,000€ të hyra të bartura nga viti 2015;
- Në nenin 14 te hyrja e parasë së gatshme të hyrat nga donacionet ishin mbivlerësuar për 4,630€;
- Neni 18- Detyrimet kontingjente ishin shpalosur në total, por jo edhe në detaje siç kërkohet me formatin e PFV; dhe
- Neni 24 - Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara - ishte i plotësuar gabimisht për shkak se në këtë nen komuna ka prezantuar gjendjen e të hyrave vetjake e jo gjendjen e fondeve të donatorëve.

Sugjerimet tona janë marr parasysh nga komuna dhe gabimet e përmendura më lart janë korrigjuar, me përjashtim të çështjeve të pasurive dhe keq klasifikimit për të cilat çështje ne e kemi theksuar opinionin. Shih nënkaptullin 1.1 Opinioni i auditimit.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale, përveç çështjeve të përmendura në opinion e auditimit të cilat ne i kemi konsideruar jo materiale.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport. Kjo gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabimet.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo pasqyron veprimet e marra të menaxhmentit në zhvillimin dhe përmirësimin e proceseve ekzistuese dhe kontrolleve. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna në listën e vetvlerësimit të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuarra përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive në sistemin qeverisës të komunës, veçanërisht në lidhje me ambientin e kontrollit dhe menaxhimit e rrezikut. Lista kontrolluese e vet-vlerësimit e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa pohime pozitive mbi ekzistimin e këtyre aranzhimeve, por që nuk bazohen në dëshmi të duhura.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit. Komuna kishte zbatuar vetëm një numër të vogël të rekomandimeve të vitit të kaluar, ku vetëm 5 nga 15 rekomandimet e dhëna ishin zbatuar plotësisht.

Komuna nuk e kishte hartuar planin strategjik dhe nuk kishte hartuar listën e rreziqeve me të cilën mund të ballafaqohet.

Kishte monitorime të dobëta tek llogarive të arkëtueshme dhe obligimet e papaguara, sepse ato po rriten nga viti në vit.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve përkatëse auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshijnë prokurimin, të hyrat, pasuritë dhe llogaritë e arkëtueshme.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2015, ka rezultuar me 15 rekomandime. Nga këto, 11 ishin me prioritet të lartë dhe 4 me prioritet të mesëm. Menaxhmenti kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Raporti i auditimit për PFV e vitit 2015 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale me datën 26.07.2016.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, 5 (pesë) rekomandime janë zbatuar (4 me prioritet të lartë dhe 1 me prioritet të mesëm), 5 (pesë) rekomandime janë në proces të zbatimit (4 me prioritet të lartë dhe 1 rekomandim me prioritet të mesëm) dhe 5 (pesë) rekomandime nuk janë zbatuar ende (3 rekomandime me prioritet të lartë dhe 2 rekomandime me prioritet të mesëm).

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

Çështja 1 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Ne kemi vërejtur se komuna edhe pse kishte caktuar një grup për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, ende ka një ngecje në zbatimin e plotë të tyre. Grupi për monitorim të zbatimit të rekomandimeve kishte mbajtur disa takime ku kishte diskutuar lidhur me mundësin e zbatimit të rekomandimeve. Megjithatë, nevojitet një proces konfirmues për shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe identifikimin e pengesave për veprim në adresimin e plotë të tyre. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësimet e vazhdueshme në komunë.

- Rreziku** Disa rekomandime po përsëriten nga viti i kaluar që tregojnë për dobësi të vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sisteme kryesore financiare e që ndërlidhen me:
- Regjistrin jo të plotë të pasurive komunale;
 - Mos hartim të listës së rreziqeve dhe mungesa e planit strategjik gjithëpërfshirës;
 - Mungesë e raportimeve menaxheriale;
 - Mos inkasim i të hyrave sipas kontratës dhe mangësi në procesin e monitorimit të objekteve të dhëna me qira; dhe
 - Adresimin e sfidave në inkasimin e llogarive të arkëtueshme.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë që grupi i caktuar për monitorim të ndërmerr veprime specifike në hartimin e një plani të qartë të veprimit me qëllim të zbatimit të rekomandimeve. Monitorimi i këtij plani duhet të bëhet të paktën çdo tremujor si dhe të zbatohet një proces rigoroz i llogaridhënies në rast të mos realizimit të këtij plani.

2.2 Pyetësi i vetëvlerësimit të komponentave të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Gjatë auditimit ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në MF, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Konkluzionet tona nuk kanë për qëllim të komentojnë cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por të pasqyrojnë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 – Pyetësi i vetë-vlerësimit – Prioritet i lartë

- E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Komuna, pyetësorin e vetëvlerësimit e kishte plotësuar duke u bazuar në planin zhvillimor komunal. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se çështjet që nuk ishin adresuar plotësisht ishin si në vijim:
1. Pyetësi i vetëvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal ka konfirmuar se komuna ende nuk ka identifikuar listën e rreziqeve të cilat mund të kanosin arritjen e objektivave dhe reagimet me kohë në rast të ndodhjes së tyre;
 2. Komuna nuk e kishte hartuar planin strategjik gjithëpërfshirës; dhe
 3. Komuna nuk bënë monitorimin e progresit të arritjes së objektivave.

Auditimi i Brendshëm nuk kishte bërë një vlerësim të pavarur për pohimet e menaxhmentit që janë në listat e kompletuara kontrolluese dhe nuk kishte raportuar për saktësinë dhe përshtatshmërinë e tyre te Zyrtari Kryesor Administrativ, siç parashihet me procedurat e MFK-së.

Rreziku Mos hartimi i planit strategjik gjithëpërfshirës dhe mungesa e hartimit të listës së rreziqeve mund të ndikon në zvogëlimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët pasi që objektivat e komunës nuk adresohen në kohën e duhur dhe në mënyrë të planifikuar.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë se do të hartohet lista e rreziqeve dhe plani strategjik. Monitorimi i strategjisë duhet të bëhet në baza të vazhdueshme për tu siguruar se objektivat strategjike janë duke u arritur. Njësia e auditimit të brendshëm duhet të bëjë rishikimin final për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese, para se e njëjta t'i dorëzohet MF.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Komunat janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike. Komuna ka hartuar një sërë dokumentesh strategjike si: Plani urbanistik i cili ishte azhurnuar në pjesën e planifikimit hapësinor në vitin 2013, strategjinë e zhvillimit rajonal 2010-2015, strategjinë e zhvillimit lokal të vitit 2009, planin zhvillimor lokal të vitit 2011, dhe planin e reagimit emergjent për Komunën e Rahovecit.

Çështja 3 - Dokumentet strategjike - Prioritet i lartë

E gjetura Ne kemi identifikuar se Komuna e Rahovecit nuk i ka të hartuar dokumentet si: planin kundër korrupsionit, planin strategjik gjithëpërfshirës.

Rreziku Mungesa e dokumenteve strategjike e pengon vendosjen e objektivave afatgjata të zhvillimit të përgjithshëm dhe matjen e progresit në arritjen e këtyre objektivave të komunës, si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet të hartoj planet strategjike dhe të vendos objektiva të qarta të zhvillimit në gjithë sektorët e komunës, si dhe të njëjtat të monitorohen në mënyrë sistematike për të vlerësuar planifikimet fillestare dhe progresin në arritjen e objektivave në periudhat e caktuara.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 4 - Mungesa e raportimeve mujore – Prioriteti i lartë

E gjetura Komuna posedon në formë të shkruara vetëm procesverbalet që rezultojnë nga takimet e Bordit të Drejtorëve, ndërsa nuk ka raporte mujore me shkrim të përgatitura nga drejtorët e drejtorive për Kryetarin e Komunës ku do të duhej të përshkruhen aktivitetet operative dhe financiare.

Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2016 Zyrtari Kryesor Financiar i secilës komunë i dorëzon Kryetarit të Komunës brenda tre (3) javëve nga mbyllja e secilit tremujor një raport të detajuar për progresin e arritur në zbatimin e të gjitha projekteve kapitale me vlerë më të lartë se 10,000€. Një kopje e raportit të tillë duhet t'i dorëzohet edhe Ministrit të Financave, mirëpo këto raporte nuk ishin përgatitur dhe dorëzuar sipas kërkesave ligjore.

Rreziku Mungesa e raporteve mujore nga drejtorët tek Kryetari i Komunës, redukton aftësinë e menaxhmentit për të drejtuar në mënyrë efektive aktivitetet e komunës, për të reaguar ndaj sfidave financiare në kohën e duhur dhe për të zbatuar kontrollin efektiv të buxhetit.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ dhe të bëhen raportimet mujore me shkrim nga drejtorët tek menaxhmenti. Po ashtu, të merr masa për t'u siguruar se raportimet nga ZKF-së të bëhen sipas kërkesave ligjore për progresin fizik të investimeve kapitale.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me një auditor i cili është edhe drejtor i njësisë. NJAB kishte përgatitur planin strategjik dhe planin vjetor të auditimit të brendshëm i cili ishte aprovuar nga menaxhmenti. NJAB kishte planifikuar 7 (shtatë) raporte të auditimit, të cilat i kishte përfunduar. Auditimet e kryera kishin të bëjë me: (1) Të hyrat dhe shpenzimet në drejtorinë e kadastrit dhe gjeodezisë (auditimi i aktiviteteve të vitit 2015 dhe tre mujori i vitit 2016), (2) Të hyrat dhe shpenzimet në drejtorinë e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor (auditimi i aktiviteteve të vitit 2015 dhe tre mujori i vitit 2016), (3) Të hyrat dhe shpenzimet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (auditimi i aktiviteteve të vitit 2015 dhe 2016), (4) Të hyrat dhe shpenzimet në drejtorinë e shërbimeve publike (auditimi për vitin 2015 dhe 2016), (5) Të hyrat dhe shpenzimet në drejtorinë e administratës (auditimi i aktiviteteve të vitit 2016), (6) Të hyrat dhe shpenzimet në drejtorinë për buxhet dhe financa, dhe (7) Auditimi i Zyrës së prokurimit, respektivisht inicimin e procedurave të prokurimit për vitin 2016.

Çështja 5 – Njësia e Auditimit të Brendshëm – Prioriteti i lartë

E gjetura Ne, nuk jemi mbështetur në punën e NJAB për faktin se disa raporte fokus kishin aktivitetet e vitit 2015 dhe objektivat tona dallojnë nga ato NJAB. Po ashtu, raportet e NJAB nuk ishin të qarta dhe të dokumentuara në mënyrën e duhur dhe si rezultat i saj trajtimi i çështjeve të prezantuara në raporte nuk i ofron siguri të mjaftueshme menaxhmentit.

Komiteti i Auditimit nuk ka qenë funksional gjatë vitit 2016, edhe pse ishte themeluar që nga viti 2014.

Rreziku Auditimi i brendshëm nuk kishte ofruar sigurinë e duhur mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme. Mungesa e kontributit të pritur nga NJAB rritë rrezikun që sistemi i kontrollit të brendshëm të mos përmirësohet. Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit të brendshëm ndikon në vlerësimin, cilësinë dhe mos fuqizimin e njësisë së auditimit të brendshëm.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të sigurojë se auditimi brendshëm do të ketë në fokus të veçantë aktivitetet në vitin aktual dhe kontributi i tij të jetë më produktiv përmes raporteve kualitative. Po ashtu, të siguroj që komiteti i auditimit të funksionalizohet brenda një periudhe të arsyeshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në komunë. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna ka të ndërtuar një sistem të kontrollit të brendshëm i cili operon në përgjithësi, por efektiviteti i kontrollit ka nevojë të përmirësohet në disa fusha të caktuara ku janë identifikuar mangësi. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime janë: Monitorimi i objekteve të dhëna me qira, prokurimi, menaxhimi i pasurisë, menaxhimi i llogarive të arkëtueshme dhe rritja e obligimeve të pa paguara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,158,014	1,158,014	1,009,926	969,696	1,017,555

Prej gjithsej të hyrave vetjake të planifikuara (1,158,014€), komuna kishte arritur që të inkasoj 87% (1,009,926€) të shumës së planifikuar. Në totalin e të hyrave të mbledhura janë përfshirë edhe të hyrat nga gjobat e gjykatës (72,420€) dhe trafikut (59,764€).

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	11,384,998	11,970,412	11,567,016	11,473,317	10,463,701
Granti i Qeverisë -Buxheti	10,226,984	10,458,940	10,420,032	10,403,275	9,530,093
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	247,444	245,380	256,666	166,113
Të hyrat vetjake ⁴	1,158,014	1,158,014	801,797	746,922	737,857
Donacionet e brendshme	-	11,512	5,400	0	0
Donacionet e jashtme	-	94,502	94,407	66,454	29,638

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 585,414€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak (247,444€), nga donacionet (106,014) dhe rritjes së grantit të Qeverisë (231,956€) pas rishikimit buxhetor.

Në vitin 2016, komuna kishte shpenzuar 97% të buxhetit, pra është një nivel mjaft i lartë i realizimit të buxhetit, me një ngritje të lehtë për 2% në raport me vitin e kaluar.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,384,998	11,970,412	11,567,016	11,473,317	10,463,701
Pagat dhe Mëditjet	6,895,620	7,002,751	6,966,078	6,818,898	6,228,063
Mallrat dhe Shërbimet	686,913	659,262	657,625	771,189	634,577
Shërbimet komunale	270,500	250,500	250,497	280,665	226,174
Subvencionet dhe Transferet	123,312	174,340	173,992	142,160	105,951
Investimet Kapitale	3,408,653	3,883,559	3,518,824	3,460,405	3,268,936

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të realizuara nga komuna në 2016, ishin 1,009,926€. Ishte shënuar një rritje rreth 4% krahasuar me vitin e kaluar. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksa tjera administrative.

Gjatë auditimit të fushës së të hyrave vetjake, identifikua mangësitë si në vijim:

Çështja 6 – Të hyrat nga tatimi në pronë dhe dhënia me qira e objekteve - Prioritet i mesëm

E gjetura Me rastin e planifikimit të të hyrave nga tatimi në pronë, komuna nuk bën një vlerësim të përshtatshëm të kapaciteteve inkasuese duke u bazuar në trendet e inkasimit nga vitet e kaluara. Në vitin 2016 kishte planifikuar të inkasoj 332,000€, nga tatimi në pronë, ndërsa ishin inkasuar 370,509€. Gjithashtu, kemi identifikuar se komuna nuk kishte arritur të bëjë verifikimin e 1/3 e pronave të regjistruara, për tatimin në pronë. Sipas regjistrit të tatimit në pronë komuna ka 14,894 prona komunale të regjistruara, ndërsa gjatë vitit 2016 kishte bërë vetëm 198 verifikime (sipas regjistrit të ofruar).

Ne kemi vërejt mungese aktiviteti nga komuna për mbledhjen e të hyrave nga dhënia me qira e objekteve komunale. Në 5 raste kemi rishikuar kontratat për shfrytëzim të objekteve komunale me qira dhe kemi vërejtur se obligimi financiar i shfrytëzuesve ndaj komunës është 43,459€.

Rreziku Planifikimi pa mbështetje në analiza të trendëve inkasuese, paraqet bazë për planifikim të dobët. Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të mos mblidhen.

Mos mbledhja e të hyrave nga objektet e dhëna me qira ndikon që projektet kapitale të planifikuara të financohen nga hyrat vetjake, të mos realizohen.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të siguroj se me rastin e planifikimit të të hyrave nga tatimi në pronë do të merret parasysh trendi i inkasimit të periudhave të mëparshme dhe të siguroj se verifikimi i pronave komunale bëhet në baza të rregullta vjetore, siç parashihet me ligj. Duhet të administroj me kujdes të gjitha pronat komunale dhe të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike në rastet e mos kryerjes së detyrimeve financiare ndaj komunës.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 7,002,751€, dhe të njëjtat ishin shpenzuar pothuajse maksimalisht 6,966,078€ apo 99%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit, (punëtorët aktual, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave, pensionet, dhe pagesat për këshilltarët komunal). Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës. Në mostrat tona, nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunal në vitin 2016 ishte 909,762€. Prej tyre ishin shpenzuar 908,122€. Nga mostrat tona, nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për raportim.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 174,340€, ndërsa shpenzimi 173,992€. Komuna ka një rregullore të brendshme si bazë përmes të cilës ndahen subvencionet. Nga rishikimet tona, nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për tu raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,883,559€, ndërsa shpenzimet 3,518,824€.

Çështja 7 – Dobësi në procedura të prokurimit - Prioritet i lartë

E gjetura Në projektin “Blerja e instrumentit gjeodezik” komuna kishte lidhur kontratë me operatorin ekonomik (OE) me çmimin më të lartë, edhe pse sipas komisionit për vlerësimin e ofertave operatori me çmim më të ultë i kishte përmbushur kriteret dhe ishte i përgjegjshëm. Kontrata ishte lidhur në vlerë 11,978€ ndërsa çmimi i ofruar nga OE konkurrent ishte 9,250€. Më tutje, zyra e prokurimit nuk e kishte njoftuar me shkrim OE të eliminuar nga tenderi lidhur me arsyet e eliminimit.

Në tri raste, zyra e prokurimit nuk kishte njoftuar me shkrim operatorët ekonomik për arsyen e eliminimit të tyre nga tenderi.

Rreziku Shpërblimi i OE me çmim më të lart ndikon në dëmtimin e buxhetit komunal. Mos njoftimi i OE me shkrim për eliminim nga tenderi, i pa mundëson OE të eliminuar që të bëjnë ankesa në institucionet kompetente.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të analizoj arsyet pse në rastet e mësipërme nuk janë zbatuar kërkesat e prokurimit me konsistencë dhe në të ardhmen siguroj se janë shpërblyer OE me çmimet më të volitshme për komunën, si dhe do të bëhet me shkrim njoftimi i OE për eliminim nga tenderi.

Çështja 8 - Lidhja e kontratave më shumë se sa ndarjet buxhetore – Prioritet i mesëm

E gjetura Në projektin “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Rahovec - Pataqan i poshtëm” Komuna më 16.09.2016 kishte lidhur kontratë me çmim më të lartë se sa ndarjet buxhetore të parapara me tabelën 4.2 për projekte kapitale. Kontrata ishte nënshkruar në vlerë 845,981€ ndërsa ndarjet buxhetore ishin 75,000€ (2016) dhe vlerësimet për dy vitet vijuese ishin 130,000€ (2017) dhe 100,000€ (2018).

Ngjashëm ishte edhe te projekti “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Drenoc – Zatriq. Kontrata ishte nënshkruar në vlerë 348,947€ ndërsa ndarjet buxhetore për vitin 2016 ishin 55,000€ dhe vlerësimet për dy vitet vijuese ishin 100,000€ (2017) dhe 80,000€ (2018).

Rreziku Nuk është e qartë si do të përfundohen këto projekte, përderisa nuk është i qartë konstruksioni financiar i projekteve. Hyrja e komunës në kontrata më shumë se sa ndarjet buxhetore të parapara me ligj të buxhetit, rritë rrezikun që projektet e tilla të vonohen, të dëmtohen para se të jenë kryer, e madje edhe të mos përfundohen.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të zbatoj kërkesat e ligjit dhe rregulloreve financiare që të mos hyj në kontrata me operatorët, para se t’i zotoj fondet e duhura dhe të siguroj se nuk do të hyjë në obligime kontraktuese përtej ndarjeve buxhetore të parashikuara me ligjin për buxhetin vjetor.

Çështja 9 - Dobësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në projektin “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Retijë – Mamushë”, Komuna me 23.06.2016 kishte lidhur kontratë në vlerë 99,355€. Ne kemi identifikuar që publikimi për dhënie të kontratës ishte bërë më 31.05.2016 pa prezantuar dokumentin e kërkuar në dosje të tenderit ‘Vërtetimi nga Gjykata Themelore’ dhe i cili dokument ishte sjellë më 09.06.2016, respektivisht nëntë (9) ditë pas publikimit.
- Rreziku** Mos ofrimi i dëshmive me kohë i operatorëve pjesëmarrës në tender, përveç që është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit, rrit rrezikun që OE të mos jetë operatori më i përshtatshëm dhe diskriminon pjesëmarrësit tjerë.
- Rekomandimi 10** Kryetari duhet të siguroj që zyra e prokurimit të respektoj në përpikëri kërkesat e dosjes së tenderit, në mënyrë që lidhja e kontratave të bëhet me OE të përgjegjshëm dhe procedurat të jenë plotësisht transparente.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Komuna gjatë vitit 2016 kishte vazhduar të regjistroj pasuritë komunale në regjistrin kontabël. Vlera e pasurisë së regjistruar në PFV e vitit 2016 është 60,556,000€ ndërsa në vitin 2015 ishte 52,206,000€. Pra, kemi një trend pozitiv sa i përket regjistrimit të pasurive komunale. Megjithatë, komuna ende nuk ka arritur të kompletoj regjistrin gjithëpërfshirës të pasurisë komunale.

Çështja 10 - Menaxhimi i pasurive përmes softuerit E-pasuria - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sistemi i E-pasurisë ende nuk funksionon plotësisht. Në E-pasuri regjistrohen pasuritë nën 1,000€ të administratës komunale dhe drejtorisë së arsimit, ndërsa nuk regjistrohen pasuritë e drejtorisë së shëndetësisë.
- Rreziku** Mosfunksionimi i plotë i sistemit të e-pasurisë, pamundëson menaxhimin dhe kontrollet e pasurive dhe stoqeve në dispozicion, dhe kjo rrit rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të pasurive.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit të E-pasurisë dhe të fuqizoj kërkesat që të gjitha pasuritë dhe stoqet nën 1,000€ të regjistrohen në këtë sistem.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme (LLA) në fund të vitit 2016 ishin 2,074,000€ dhe krahasuar me vitin paraprak (1,940,000€) ato janë rritur për 134,000€.

Çështja 11 - Politika të dobëta në inkasimin e llogarive të arkëtueshme - Prioritet i mesëm

E gjetura Në komunë kemi rritje të llogarive të arkëtueshme vit pas viti. Kjo rritje është për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarr veprime konkrete për t'i mbledhur ato. Vlerën e këtyre LLA e përbëjnë tatimi në pronë (1,195,000€), taksat në veprimtari afariste (818,000€), qiraja nga lokalet dhe hapësira publike 61,000€.

Rreziku Mos arkëtimi i borxheve mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të shpenzimeve. Politikat jo efikase të komunës në trajtimin e këtyre llogarive, kanë rezultuar në rritjen e tyre dhe kjo rritje rrezikun e mos realizimit të projekteve komunale të planifikuara nga burimet vetjake. Po ashtu, nëse llogaritë e tilla nuk mbledhen për një kohë të gjatë, mund të shndërrohen në borxhe të këqia dhe të bëhen të pa mbledhshme.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të sigurojë inicimin e një procesi të rivlerësimit, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për inkasim, dhe të propozoj masa konkrete, duke mos i përjashtuar edhe masat administrative dhe të tjera (nëse ka nevojë).

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 920,458€ që krahasuar me vitin e kaluar (333,000€), shihet një rritje e konsiderueshme e këtyre të detyrimeve. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

Çështja 12 - Rritja e obligimeve të pa paguara - Prioritet i lartë

- E gjetura** Gjatë auditimit të obligimeve kemi identifikuar se obligimet ishin rritur për 587,458€ në raport me vitin paraprak. Kjo është rezultat i kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme në fushën e obligimeve dhe hyrjes në obligime kontraktuale pa mjete të mjaftueshme.
- Rreziku** Shumat e raportuara të detyrimeve të pa paguara janë shumë domethënëse për buxhetin e komunës, dhe si të tilla, mund të shkaktojnë lëkundje të mëdha buxhetore. Kontraktimi pa fonde të mjaftueshme rezulton me rritjen e obligimeve dhe e ndikon buxhetin dhe objektivat e vitit të ardhshëm për shkak se Thesari mund të ekzekutoj pagesa dhe të hapen konteste gjyqësore nga operatorët ekonomik.
- Rekomandimi 13** Kryetari duhet të analizoj me një kujdes të madh arsyet pse komuna në mënyrë të pa kontrolluar krijon obligime, financimi i të cilave nuk është aspak i sigurt. Rrjedhimisht, duhet t'i forcoj kontrollet që ndërlidhen më obligimet dhe të siguroj se nuk do të hyj në obligime kontraktuese, pa e pasur të sigurt burimin e fondeve.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.5 Rekomandimet	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rreziqet domethënës për keq klasifikim të shpenzimeve dhe shpalosjen e pasurive. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime.		Komuna kishte regjistruar pagesat nga palët e treta në SIMFK ndërsa në vitin 2016 kishte keq klasifikim të shpenzimeve dhe regjistri i pasurive ende i pa kompletuar.	
2.3 Zbatimi i rekomandimet e vitit paraprak (çështja 2)	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin e plotë të rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.	X		
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit (çështja 3)	Kryetari duhet të sigurojë se plotësimi i listës kontrolluese të vetëvlerësimit të jetë më kritik dhe të siguroj adresimin e fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të rishikohet mundësia e azhurnimit të strategjisë së zhvillimit komunal e cila do të përfshinte objektivat e qarta dhe arritjen e synimeve komunale. Po ashtu, të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për të siguruar dëshmitë mbështetëse lidhur me pohimet e vetëvlerësimit.		Lista kontrolluese është përgatit nga komuna por Auditimi i Brendshëm nuk kishte bërë një vlerësim të pavarur për pohimet e menaxhmentit që janë në listat e kompletuara kontrolluese dhe nuk kishte liste për menaxhimin e rreziqeve.	

2.5.1 vlerësimi i rrezikut (çështja 4)	Kryetari duhet të sigurojë se është hartuar një listë ku rreziqet janë identifikuar sipas niveleve dhe gjasave që ato mund të ndodhin, si dhe janë parashikuar masat si kundërpërgjigje nëse ato ndodhin. Gjithashtu, përgjegjësia për menaxhimin e rrezikut duhet të delegohet tek një përgjegjës i cili do të raportoj tek menaxhmenti dhe të sigurojë zbatimin e kërkesave në këtë fushë.			X
2.5.2 Raportimi Menaxherial (çështja 5)	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.			X
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm (çështja 6)	Kryetari duhet të bëjë planin e veprimit, i cili duhet të zbatohet, duke i konfirmuar zyrtarët përgjegjës dhe kohën për kryerjen e veprimeve. Auditimi brendshëm duhet të ketë në fokus të veçantë aktivitetet në vitin aktual, me efekt parandalues të veprimit. Për të fuqizuar rolin e auditimit të brendshëm, Komiteti i Auditimit duhet të funksionalizohet.			X
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit (çështja 7)	Qasja ndaj planifikimit buxhetor për projekte kapitale ka nevojë për përmirësime thelbësore. Para se të përcaktohen fondet për investime, komuna duhet të analizoj me kujdes dhe objektivitet se cilat projekte janë prioritare dhe cilat prej tyre kanë gjasa reale të realizohen. Procedurat e filluara me kohë (hartimi i projektit, sigurimi i ekzekutimit, prokurimi, etj.) janë disa nga parakushtet që projektet të realizohen sipas planit.	X		

3.4 Prokurimi (çështja 8)	Kryetari duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuara janë adresuar. Të siguroj se komuna nuk do të hyjë në obligime më shumë se sa ndarjet buxhetore të parashikuara me ligjin e ndarjeve buxhetore.		Njoftimi me shkrim për operatorët e eliminuar nga tenderi është bërë, sasitë e përfaqësuara janë përcaktuar në dosje të tenderit, janë minimizuar procedura të prokurimit të cilat nuk ishin të përfshira në planin e prokurimit. Hyrja në obligime me shumë se sa ndarjet buxhetore edhe në vitin 2016 kishte raste të tilla.	
3.4 Prokurimi (çështja 9)	Menaxheri i Projektit nuk ka zbatuar kushtet e kontratës si dhe të siguroj se paramasat, paralogaritë dhe analizat tjera teknike për projektet që do të tenderohen, janë kryer në mënyrë të hollësishme, dhe devijimet nga kontratat fillestare të jenë brenda limiteve të lejuara. Pas shqyrtimit të rastit, ndaj personave përgjegjës të inicioj masa adekuate të përgjegjësisë.	X		
3.5.1 Shpenzimet jo përmes prokurimit (çështja 10)	Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të bëj pagesa para se të konfirmohet se punimet apo shërbimet janë kryer. Pagesat duhet të jenë të dokumentuara me raporte të konfirmuara për pranimin e punëve/shërbimeve. Aspekti i mbikëqyrjes dhe raportimit të detyrimeve që dalin nga këto marrëveshje, duhet të jetë subjekt i shqyrtimeve të rregullta nga menaxhmenti i komunës. Për të eliminuar rrezikun për dështimin e këtyre marrëveshjeve, ne do të sugjeronim që praktikën e tilla të pagesave të ndërpriten.	X		

3.5.1 Shpenzimet jo përmes prokurimit (çështja 11)	Kryetari duhet të rishikoj kontratat për shërbime të veçanta si dhe të siguroj që kontratat e tilla të përdorën vetëm për nevoja reale dhe jo të angazhohen për pozita të zakonshme.		Komuna në vitin 2016 kishte angazhuar 28 punëtor me kontrata për shërbime të veçanta dhe afati i kontratave ishte deri në 6 muaj. Komuna në disa raste kishte zhvilluar procedura të rekrutimit.	
3.5.2 Kompensimet Pagat dhe mëditjet (çështja 12)	Kryetari duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim i orareve të kujdestarive në QKMF në mënyrë që të mos tejkalohet numri i orëve shtesë dhe të respektohet ligji i punës.	X		
3.6 Te hyrat (çështja 13)	Kryetari duhet të siguroj shkëputjen e kontratave ashtu siç e parasheh vendimi i KK për qiramarrësit të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj komunës. Në të ardhmen, të bëhet verifikimi i pronave komunale siç parashihet me ligj.			X
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale (çështja 14)	Kryetari duhet që pa vonesë të formoj komisione kompetente për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjitha pasurive jo financiare si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Rezultatet e regjistrimit duhet të integrohen në një regjistër të vetëm për të gjithë sektorët. Procesi i regjistrimit të pasurive me vlera më të larta se 1,000€ në SIMFK, duhet të vazhdoj deri në regjistrimin përfundimtar. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e pasurive komunale të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores dhe mos konsolidimin e vlerës së pasurive.		Komuna e ka formuar komisionin për vlerësim të pasurisë i cili ishte kishte vlerësuar disa prona por ne gjatë vitit 2016 identifikua që ka prona të cilat ende nuk janë përfshirë në regjistrin e pasurive.	

3.7.3 Llogarit e arkëtushme (çështja 15)	Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike çështjen e realizimit të të hyrave, për të siguruar se politikat dhe masat adekuate do të ndërmerren për të maksimizuar inkasimin e borxheve. Është e nevojshme që të bëhet një analizë e detajuar që përcakton arsyet e ngecjes së pagesave, si dhe të propozohen veprimet konkrete dhe burimet e nevojshme për mbledhjen e këtyre borxheve.			X
--	--	--	--	---

Shtojca IV: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Rahovec

Dt. 03.05.2017

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Rahovecit, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari:

Idriz Vehapi

